



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1761/1 Prot.

Tiranë, më 19 / 11 / 2019

### V E N D I M

**Nr. 170, Datë 19 / 11 / 2019**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 55, datë 24.05.2019, të Z.B<sup>1</sup> kundër Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Shkollës së Mesme Profesionale “Isuf Gjata”, Korçë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar<sup>2</sup>”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### K O N S T A T O I:

#### **I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: *“Vajza e saj, për herë të parë është regjistruar pranë shkollës “Isuf Gjata” në degën (kabinet, konfeksion) në vitin shkollor 2017-2018. Për shkak se numri i nxënësve nuk ishte i mjaftueshëm, klasa nuk u hap dhe vajza e saj nuk e frekuentoi shkollën. Vajza e saj vazhdoi e regjistruar në degën Ekonomi-Biznes dhe për vitin shkollor 2018-2019 dhe filloi frekuentimin në mënyrë jo të rregullt, për arsye se nuk kishte mësues ndihmës. Pas regjistrimit ankuesja i ka kërkuar drejtores së shkollës vlerësimin e vajzës së saj nga një komision specialistësh për vendosjen e mësuesit ndihmës, i cili do ta mbështeste vajzën gjatë procesit mësimor dhe do lehtësonte marrjen e njohurive. I është drejtuar dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të cilës i ka kërkuar informacion lidhur me praktikën e përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në arsimin profesional. Nga ministria ka marrë përgjigje se nuk ka një praktikë të veçantë të përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në shkollat dhe kurset profesionale.*

<sup>1</sup> Në cilësinë e prindit të fëmijës F.B.

<sup>2</sup> Referuar Vërtetimit të KMCAPI të DRSHTSH Korçë nr. 1825, datë 18.07.2018, F.B datëlindja 05.04.2000, është PAK, Grupi I, me diagnozë “Çrregullim pervaziv i zhvillimit autizëm me zhvillim të theksuar të funksionit”.

*Ankuesja shprehet se për shkak të mungesës së një mësuesi ndihmës, vajza e saj nuk ndjek rregullisht shkollën”.*

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe mbështetjen e fëmijës me mësues ndihmës.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 7 i LMD-së<sup>3</sup>, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.*

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 55, datë 24.05.2019 të Z.B u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 798/1, datë 30.05.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Shkolla e Mesme Profesionale “Isuf Gjata” Korçë për ankesën e bërë nga Z.B si dhe ka kërkuar

<sup>3</sup> Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

kopje të procedurës së përfitimit të mësuesit ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në shkollat profesionale, bazuar në parimin e gjithëpërfshirjes<sup>4</sup>.

Me shkresën nr. 130, datë 14.06.2019, Shkolla e Mesme Profesionale “Isuf Gjata” Korçë, në mes të tjerash informoi se: *“Nxënësja F.B është regjistruar me dëftesën e klasës së 9-të në vitin shkollor 2017-2018 në drejtimin Tekstil Konfeksion. Për arsye të mos hapjes së klasës, pasi nuk ishte plotësuar numri i nxënësve, vajza me dëshirën e prindit kaloi në drejtimin Shërbime Social-Shëndetësore. Në muajin Dhjetor 2017 prindi i fëmijës, njoftoi shkollën se nuk do të sillte fëmijën në shkollë për arsye se në klasë nuk kishte nxënës femra. Në Shtator 2018 nxënësja është regjistruar përsëri në drejtimin Ekonomi Biznes. Nga ana e shkollës janë organizuar disa aktivitete informuese dhe sensibilizuese me nxënësit e klasës, mësuesen kujdestare dhe mësuesit e shkollës, lidhur me nevojat e fëmijës, pavarësisht se mësuesit kanë eksperiencë me fëmijët me aftësi të kufizuara, pasi aktualisht janë dhe 3 nxënës të tjerë në shkollë. Në muajin Nëntor 2018, prindi i fëmijës ka kërkuar nga shkolla që ti vendoset një mësues ndihmës. Nxënësja vazhdon të jetë e regjistruar në klasë të X (dhjetë), por për arsye të mosfrekuentimit të mësimit, rezulton pakaluese”.*

Lidhur me pretendimet e subjektit ankues, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, pavarësisht se ka marrë njoftim nëpërmjet shërbimit postar<sup>5</sup> nuk ka kthyer përgjigje.

Me shkresën nr.798/3, datë 30.07.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar informacion nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë lidhur me procedurën dhe bazën ligjore që përdoret në institucionet arsimore publike të arsimit të mesëm të lartë, (gjimnaz dhe të arsimit të mesëm të orientuar) lidhur me caktimin e mësuesit ndihmës (nuk ka përgjigje nga MASR).

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës nr. 55, datë 24.05.2019, Komisioneri me shkresën nr. 798/4, datë 08.08.2019 njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 27.08.2019, ora 11.00, duke kërkuar shpjegime dhe kopje të dokumenteve si më poshtë:
  - Kopje të akteve nënligjore përkatëse për përcaktimin e kriterëve, procedurës së vlerësimit dhe caktimit të mësuesit ndihmës, për fëmijët me aftësi të kufizuara që duan të ndjekin shkollën e mesme të arsimit dhe formimin profesional.
  - Kopje të kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes e të emërimit të mësuesit ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit dhe formimit profesional.
  - Kopje të përgjigjes së dhënë ankueses nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, lidhur me kërkesën për mësues ndihmës, të bërë në datë 19.11.2018.

Seanca dëgjimore u zhvillua me praninë e palëve në proces: subjektit ankues, Z.B dhe L.D si përfaqësuese e ankueses dhe palëve kundër së cilës është paraqitur ankesa, Ministria e Financave

<sup>4</sup> Në nenin 5/a të Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” parashikohet se: *“Parimi i gjithëpërfshirjes: Sistemi i AFP-së ofron mundësi arsimimi dhe formimi profesional për të gjithë, pa asnjë diskriminim”.*

<sup>5</sup> Referuar Lajmërim Marrje poste nr: RR847039964AA.

dhe Ekonomisë e përfaqësuar nga Xh. P dhe Shkolla e Mesme Profesionale “Isuf Gjata” e përfaqësuar nga T. M.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, palët iu qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në.

Lidhur me aktet ligjore për përcaktimin e kriterëve, procedurës së vlerësimit dhe caktimit të mësuesit ndihmës, dhe kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes e të emërimit të mësuesit ndihmës, për fëmijët me aftësi të kufizuara që duan të ndjekin shkollën e mesme të arsimit dhe formimin profesional, nga ana e përfaqësues së MFE-së u deklarua<sup>6</sup> se në dijeninë e saj nuk ka të përcaktuar një udhëzim apo vendim lidhur me këtë çështje, por në ditët në vijim do dërgonte përgjigje me shkrim për këtë çështje (nuk ka asnjë përgjigje nga MFE).

Lidhur me çështjen në diskutim, përfaqësuesja e Shkollës së Mesme Profesionale “Isuf Gjata”, informoi<sup>7</sup> se pas kërkesës së prindit të fëmijës për mësues ndihmës, nëpërmjet komunikimit me e-mail, ka vënë në dijeni Drejtoreshën e Politikave të Punësimit dhe Aftësimin Profesional në MFE, e cila i ka komunikuar me telefon që për këtë çështje duhet ta drejtonte prindin për në ministri. Gjithashtu, përfaqësuesja e shkollës deklaroi<sup>8</sup> se për shkollat e arsimit profesional nuk ka udhëzim se si bëhet vlerësimi i nxënësve me aftësi të kufizuara dhe procedurat që duhet të ndiqen për caktimin e mësuesit ndihmës.

- Në vijim të procedurës hetimore për marrjen e çdo prove dhe informacioni që i shërben procesit, Komisioneri me shkresën nr. 798/5, datë 26.08.2019 iu drejtua përsëri MASR duke i kërkuar informacion mbi procedurën dhe bazën ligjore që përdoret në institucionet arsimore publike të arsimit të mesëm të lartë, (gjimnaz dhe të arsimit të mesëm të orientuar) lidhur me caktimin e mësuesit ndihmës.

Me shkresën nr. 7697/1, datë 26.08.2019, të administruar pranë Komisionerit në datë 27.08.2019, MASR informoi Komisionerin se, MASR në zbatim të nenit 97 të Ligjit 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në RSH”, i ndryshuar, dhe Kreut XV të Dispozitave Normative ka miratuar Udhëzimin nr. 38, datë 07.10.2014 “Për kriteret e mësuesit ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”, i cili në Kreun I, pika 5, ka parashikuar procedurat e caktimit të mësuesit ndihmës.

- Në vijim të procedurave hetimore, mbështetur në Urdhrin nr. 165, datë 16.09.2019 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, “Për kryerjen e inspektimit në MASR”,

<sup>6</sup> Referuar deklarimit gjatë seancës dëgjimore, min 22.00.

<sup>7</sup> Referuar deklarimit gjatë seancës dëgjimore, min 27.35.

<sup>8</sup> Referuar deklarimit gjatë seancës dëgjimore, min 30.25.

inspektorët e KMD-së u paraqitën pranë MASR në datë 24.09.2019, për të administruar informacionet përkatëse mbi çështjen në fjalë.

Gjatë inspektimit, inspektorët e KMD-s, morën takim me A.K, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimeve Ekonomike dhe SH.A me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore, pranë MASR.

Lidhur me procedurën për caktimin e mësuesit ndihmës në arsimin e mesëm të përgjithshëm, SH.A informoi se për caktimin e mësuesit ndihmës në arsimin e mesëm përdoren të njëjtat procedura dhe kritere si në arsimin 9-vjeçar. Edhe nxënësit me AK që ndjekin arsimin e mesëm, përfitojnë mësues ndihmës sipas rekomandimit të Komisionit multidisiplinar të DAR/ZA-së, pasi nuk ka asnjë akt ligjor që diferencon nxënësit me AK për të ndjekur arsimin e mesëm dhe për të përfituar mësues ndihmës. Përfaqësuesi i MASR vuri në dispozicion të KMD-së, tabelën me informacionin për shpërndarjen mësuesve ndihmës në arsimin e mesëm, për vitin shkollor 2018-2019. Sipas këtij informacioni, gjatë vitit të kaluar shkollor në institucionet arsimore të arsimit të mesëm të përgjithshëm, kanë dhënë mësim 18 mësues ndihmës.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë të pretenduar nga subjekti ankues.**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka marrë në shqyrtim pretendimin e ankueses për trajtim diskriminues nga ana e MFE dhe Shkollës së Mesme Profesionale “Isuf Gjata”, Korçë, në procedurën për sigurimin e mësuesit ndihmës për vajzën e saj, për shkak të aftësisë së kufizuar.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 1 dhe neni 3/1, parashikojnë se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e saj për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin në përmbushjen e detyrave të tij, veçanërisht duke i dhënë informacionin që i nevojitet atij”.*

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë

që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Referuar Vendimit nr. 503, datë 13.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjesisë shtetërore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”, fusha e arsimit dhe formimit profesional është nën përgjegjësinë e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë e cila është përgjegjëse për zhvillimin e politikave shtetërore në këtë fushë.

Arsimi dhe formimi profesional në Republikën e Shqipërisë rregullohen sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 15, datë 16.02.2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”. Referuar nenit 2/ç, qëllimi i këtij ligji është që të garantojë mundësi të barabarta për të gjithë individët që duan të ndjekin studimet në fushën e Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP). Në nenin 5/a dhe d, të këtij ligji përcaktohet se: “*Sistemi i AFP-së bazohet në këto parime themelore: a) Parimi i gjithëpërfshirjes: Sistemi i AFP-së ofron mundësi arsimimi dhe formimi profesional për të gjithë, pa asnjë diskriminim. d) Parimi i garantimit të pjesëmarrjes: Sistemi i AFP-së krijon kushtet financiare, fizike dhe shoqërore për individët për të përfitur nga mundësitë e të nxënit gjatë gjithë jetës*”. Ndërsa në nenit 7/ç përcaktohet: “*Ministria përgjegjëse për AFP-në ka këto kompetenca: ç) siguron burimet e nevojshme njerëzore, financiare e logjistike për funksionimin e AFP-së*”.

Mungesa e akteve nënligjore për vlerësimin e aftësisë së kufizuar dhe caktimin e një mësuesi ndihmës në arsimin dhe formimin profesional ka prekur drejtpërdrejtë subjektin ankues, pasi fëmija FB, referuar vendimit të KMCAP, është person me aftësi të kufizuara.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga palët, Komisioneri vlerëson se Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si institucioni përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional, pavarësisht se është vënë në dijeni nga prindi<sup>9</sup> dhe nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>10</sup>, nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për t’ju përgjigjur pretendimeve të ankueses dhe për t’i dhënë zgjidhje ligjore çështjes së frekuentimit të arsimit dhe formimit profesional nga fëmijët me aftësi të kufizuara.

Lidhur me arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor parauniversitar, legjislacioni shqiptar, në nenin 64/3 të Ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton si detyrim ligjor që institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, të krijojë një komision, të përbërë nga mjekë, psikologë, mësues dhe specialistë për fëmijët me aftësi të kufizuara, i cili, pasi shqyrton kërkesën e prindit ose të drejtorit të një institucioni arsimor, jep rekomandimet përkatëse për ndjekjen nga fëmija të një institucioni arsimor të zakonshëm a të specializuar. Gjithashtu, referuar parashikimit të nenit 65, pika 3, të Ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nxënësve me aftësi të kufizuara u sigurohen dhe mësues ndihmës dhe

<sup>9</sup> Referuar kërkesës për mësues ndihmës të bërë nga prindi i fëmijës datë 19.11.2018.

<sup>10</sup> Referuar shkresës nr.798/1, datë 30.05.2019, shkresës nr. 798/4, datë 08.08.2019 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe deklaratës së përfaqësueses së MFE në seancën dëgjimore të datës 27.08.2019.



shërbim rehabilitues, sipas kritereve të përcaktuara me udhëzim të ministrit, kjo për t'u siguruar një kujdes akoma edhe më të veçantë, si dhe për të ndihmuar në mbarëvajtjen e tyre në shkollë.

Referuar<sup>11</sup> të dhënave të vëna në dispozicion nga MASR, vlerësohet se fëmijëve me aftësi të kufizuara që ndjekin shkollën në institucionet arsimore publike të arsimit të mesëm të lartë, (gjimnaz dhe të arsimit të mesëm të orientuar), bazuar në procedurat e sipërcituara u sigurohet ndjekja e shkollës si dhe asistohen nga mësues ndihmës sipas rekomandimeve të Komisionit multidisiplinar të DAR/ZA-ve.

Ndërkohë që për nxënësit me aftësi të kufizuara që duan të ndjekin mësimin në institucionet arsimore publike janë bërë parashikimet e sipërcituara, sipas neneve 64 dhe 65, të Ligjit 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, **për nxënësit me aftësi të kufizuara që duan të ndjekin mësimin në institucionet e arsimit dhe formimit profesional nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nuk është parashikuar asnjë procedurë se si mund të bëhet e mundur ndjekja e mësimin dhe sigurimi i mësuesit ndihmës nga fëmijët me aftësi të kufizuara në arsimin dhe formimin profesional.**

Nga sa rezultoi gjatë shqyrtimit të ankesës, drejtoria e Shkollës së Mesme Profesionale “I. Gjata”, Korçë ka vënë në dijeni<sup>12</sup> MFE-në për problematikën e ndjekjes së shkollës për nxënësen F.B, por MFE, nuk ka bërë asnjë përpjekje për ti dhënë zgjidhje çështjes së ngritur nga prindi i fëmijës dhe drejtori i shkollës. Kjo ka bërë që nxënësjja FB, të mos marrë shërbimin që duhet ti ofrohet, dhe të cenohet në të drejtën e saj për një trajtim sa më dinjitoz, me qëllim integrimin dhe ofrimin e arsimimit në përputhje me standardet që kërkojnë aktet ndërkombëtare dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se Ministria e Financave dhe Ekonomisë kishte barrën e provës<sup>13</sup> që të provonte, që nga ana e saj, janë marrë të gjitha masat e nevojshme për garantimin e ndjekjes së arsimit dhe formimit profesional për fëmijët me aftësi të kufizuara, si dhe të vinte në dispozicion të Komisionerit të gjitha aktet ligjore që parashikojnë këtë proces.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se në kuptim të nenit 7/1<sup>14</sup> të Ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ankuesja, është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë dhe të pabarabartë, nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, përmes mungesës

<sup>11</sup> Shkresa nr. 7697/1, datë 26.08.2019 dhe dokumentacionit të administruar gjatë inspektimit datë 24.09.2019.

<sup>12</sup> Referuar e-mail-it datë 24.11.2018 të Shkollës “I.Gjata” Korçë, drejtuar MFE-së.

<sup>13</sup> Neni 82, pikat 2 dhe 3, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar) parashikon: “2.Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj. 3. Në mënyrë që të mbështesin pretendimet e tyre, palët mund t'i bashkëlidhin kërkesës për fillimin e procedurës administrative dokumente ose fakte të ndryshme.”

<sup>14</sup> Neni 7/1, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

së hartimit të procedurave ligjore për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin dhe formimin profesional dhe sigurimit të mësuesit ndihmës.

## **B. Shkaku i mbrojtur.**

Në ankesën nr. 55, datë 24.05.2019, të Z.B, pretendohet diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”, nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Shkollës së Mesme Profesionale “Isuf Gjata” Korçë.

“Aftësia e kufizuar” është shkak për të cilin Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në lidhje me pretendimin e ankueses për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”, Komisioneri vlerëson se shtetasja F.B, referuar vendimit të KMCAPI i cili e ka vlerësuar atë me diagnozën: “Çrregullim pervaziv i zhvillimit autizëm me zhvillim të theksuar të funksionit”, mbart shkaku e aftësisë së kufizuar.

## **C. Lidhja e trajtimit të padrejtë me shkaku e mbrojtur.**

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezulton se fëmija F.B i është nënshtruar një një trajtimi të padrejtë dhe të pabarabartë, nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, përmes mungesës së hartimit të procedurave ligjore për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin dhe formimin profesional dhe sigurimit të mësuesit ndihmës, krahasuar me fëmijët e tjerë që ndjekin arsimin e mesëm të lartë, gjimnaz dhe të arsimit të mesëm të orientuar.

“Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara” e ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 108/2012, datë 15.11.2012, i ofron mbrojtje personave me aftësi të kufizuar, duke ndryshuar para së gjithash, trajtimin e aftësisë së kufizuar nga ai bazuar në modelin mjekësor, në trajtimin sipas modelit social. Konventa ka për qëllim të nxisë, të mbrojë dhe t’u sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre. Parimi i mosdiskriminimit është një ndër parimet e kësaj Konvente, ku ofrohet një mbrojtje e veçantë për fëmijët me aftësi të kufizuar, për të siguruar që këto fëmijë të gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut njësoj si të gjithë fëmijët e tjerë.

Në këtë kuadër, legjislacioni shqiptar në fushën e arsimit i jep përparësi të dukshme, trajtimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, në institucionet arsimore shqiptare. Qëllimi kryesor i këtij legjislacioni në tërësinë e tij, është krijimi i të gjithë kushteve të nevojshme, që fëmijët me aftësi



të kufizuara të mund të arsimohen njëloj si të gjithë fëmijët e tjerë, si dhe ajo që vlen të theksohet më tepër është prioriteti i këtij legjislacioni për t'i përfshirë dhe integruar ata në institucionet arsimore të zakonshme.

Në frymën e Konventës, është miratuar, Ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, që ka si qëllim, të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes; të përcaktojë përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim mundësimin e pjesëmarrjes së tyre, të barabartë në shoqëri.

*Persona me aftësi të kufizuara*, sipas këtij ligji, janë, individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët.

*Jetesa e pavarur*, u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët. Ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” përcakton se, një nga aspektet që siguron jetesën e pavarur për personat me aftësi të kufizuara është edhe aksesin në arsimim<sup>15</sup>. Në gjurmën “b”, të pikës 2, të nenit 5, të Ligjit nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” parashikohet se: “Politikat shtetërore mbështetin personat me aftësi të kufizuara që të kenë akses në të gjitha sferat e jetës e, ndër të tjera, të kenë akses përkatësisht: b) në shkollat e zakonshme dhe të studiojnë në shkollën për të cilën të dëshirojnë...”.

Integrimi i personave me aftësi të kufizuara është parashikuar dhe në “Planin Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016-2010”<sup>16</sup>, i cili në qëllimin strategjik 4, ka përcaktuar se: “Të sigurohet arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara. Në objektivin 1 të këtij qëllimi ka përcaktuar se: “Përmirësimi i cilësisë së arsimit gjithëpërfshirës dhe forcimi i kapaciteteve të mësimdhënies për fëmijët me lloje të ndryshme të aftësive të kufizuara”. Thelbi i reformave në këtë sektor do të përbëhet nga futja e komisioneve multidisiplinore të arsimit, futja e mësuesve ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara që studiojnë në shkollat të zakonshme dhe përgatitja e materialit të ri didaktik. Do të vendoset

<sup>15</sup>Neni 5, pika 1, e Ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” parashikon: “*Jetesa e pavarur u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët, kur është nevoja, nëpërmjet ofrimit të mbështetjes dhe të ndihmës, bazuar në zgjedhjen dhe aspiratat e vetë individit për nevojat e jetës së përditshme, përfshirë aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime e mundësi të tjera, si dhe nëpërmjet pjesëmarrjes në të gjitha sferat e jetës, përfshirë jetën familjare, komunitare dhe qytetare.*”

<sup>16</sup> Plan i Kombëtar i Veprimit për PAK 2016-2020” i miratuar me VKM nr. 483, datë 29.06.2016.

ndjekja individuale dhe koordinimi midis ministrive të ndryshme, me qëllim që të garantohet arsimimi i çdo fëmije me aftësi të kufizuar”.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në nenin 1, të tij rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me etninë,.....ose çdo shkak tjetër” dhe qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike, në qasje me sa parashikohet prej tij.

Mbëshetur në parashikimet e Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, konkretisht të nenit 3/1: *“Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”*.

Për të vërtetuar se ndaj subjektit ankues ka një sjellje diskriminuese nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe trajtimit të pafavorshëm të ankueses.

Neni 57/1 dhe 4 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ka sanksionuar se: 1. *“Kushdo ka të drejtën për arsimim”*, 4. *“Arsimi i mesëm profesional dhe i lartë mund të kushtëzohet vetëm nga kritere aftësie”*.

Në nenin 2/ç të Ligjit nr.15, datë 16.02.2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet se: *“Ky ligj ka për qëllim: ç) të garantojë mundësi të barabarta për të gjithë individët që duan të ndjekin studimet në AFP”*.

Trajtimi aktual i fëmijëve me aftësi të kufizuara që duan të ndjekin arsimin dhe formimin profesional, bie ndesh dhe me vetë qëllimin e Ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”, i cili në parimet kryesore të tij, ka parimin e gjithëpërfshirjes dhe ofrimin e mundësisë së arsimit dhe formimit profesional për të gjithë, pa asnjë diskriminim.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se MFE, ishte në dijeni të problematikës së fëmijës F.B, dhe se nuk kishte vepruar deri më tani të ndërrmerre masa konkrete për vlerësimin dhe zgjidhjen e situatës.

Drejtuesi i shkollës “Isuf Gjata”, në cilësinë e personit përgjegjës për drejtimin e shkollës, nisur nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës, ka marrë masa duke e regjistruar nxënësen në shkollë si dhe ka njoftuar MFE për problematikën, objekt shqyrtimi.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshton të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të

gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjitha institucionet.

Kjo është në të njëjtën frymë me parashikimet ligjore të LMD-së<sup>17</sup>. Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, është një ligj që rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, si dhe përcakton shkaqet në bazë të cilave ndaj një personi mund të ketë diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.

Gjithashtu në ky Ligj, ka parashikuar në nenin 7/1: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”*.

Pra siç rezulton, subjekti ankues është diskriminuar në raport me fëmijët e tjerë që duan të ndjekin arsimin e mesëm të përgjithshëm apo të orientuar. Fëmijëve me aftësi të kufizuara që duan të ndjekin arsimin dhe formimin profesional, nuk i ofrohen mundësitë për t’u vlerësuar dhe për të përfituar mësues ndihmës. Pra, fëmija F.B është vënë në pozita përjashtuese dhe diskriminuese, pikërisht për shkak të aftësisë së kufizuar.

Komisioneri vlerëson se mosveprimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për të parashikuar procedurat për ndjekjen e arsimit dhe formimit profesional për fëmijët me aftësi të kufizuara, është një rast flagrant i shkeljes së dinjitetit të drejtave dhe lirive themelore të individit të sanksionuara dhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe mosndëshkimi i një sjellje diskriminuese kaq të hapur, do të minonte rëndë arsyen e vetë ekzistencës së Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezulton se mosveprimi i institucionit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ka bërë që subjektit ankues t’i mohohet e drejta e arsimit për shkak të aftësisë së kufizuar, si pasojë e diskriminimit të saj për këtë shkak.

Neni 3 i Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ka përcaktuar se: *““Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji”*.

Në këtë kontekst, referuar nenit 7, pika 1, të Ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura dhe në mungesë të një justifikimi nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Komisioneri gjykon se ankuesja

---

<sup>17</sup> Referuar nenit 3, pika 8, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe diskriminues, nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, trajtim i cili ka lidhje të drejtpërdrejtë me aftësinë e kufizuar të ankueses.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenet 1, 2, 3/1, neni 7/1, nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e diskriminimit të fëmijës F.B nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për shkak të aftësisë së kufizuar.
2. Ministria e Financave dhe Ekonomisë të hartojë aktin nënligjor përkatës për përcaktimin e kriterëve, procedurës së vlerësimit dhe caktimit të mësuesit ndihmës, kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes e të emërimit të mësuesit ndihmës, për fëmijët me aftësi të kufizuara që duan të ndjekin arsimin dhe formimin profesional.
3. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, brenda 30 ditëve nga marrja dijëni e këtij vendimi, të informojnë Komisionerin lidhur me masat e ndërmarra, për sa më sipër.
4. Në referim të nenit 33, pika 13, të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijëni.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**